

*Rrofshën, sa malet, gjuha dhe kultura arbëreshe !*

# KUMBORA



redazionekumbora@gmail.com



Viti - Anno X \* n. 100 \* Janar - Shkurt 2013

Fletë e përnuajshme informative kulturore të arbëreshëve të Molizit. Botuar nga Shoqata Kulturore Arbëreshe  
*Bollettino d'informazione culturale degli arbëreshë del Molise. Organo dell'Associazione Culturale Arbëreshe*  
Rruga (Via) Marina 93, Cap. 86049 RUR (URURI - CB) \* Fax 0874 830219 cell. 3384783595 \*

Per liquidare i popoli si comincia con il privarli della memoria. Si distruggono i loro libri, la loro cultura, la loro storia. E qualcun altro scrive loro altri libri, li fornisce di un'altra cultura, inventa per loro un'altra storia. Dopo di che il popolo incomincia lentamente a dimenticare quello che e' stato. E il mondo attorno a lui lo dimentica ancora più in fretta.



## Editorial, Editoriale

*Kush jimi sot?*

di: *Luis de Rosa*

*faqja 2*

## Kultura

*Mbinjeri 2030*

di: *Pal Borxha*

*faqja 7 e 8*

## Histori

*Gjergji Pelini*

di: *Prof. Dr Jahja Drançolli*

*faqja 4,5 e 6*

## Këndi i poezisë, L'angolo della poesia

*Poezi e pakryer*

di: *Rexhep Shahu*

*faqja 11*

## Kush jimi sot?

Ng'e di ju, po u' sa herë vinj udhës ka hora kur shkonj ndonjëherë jashta, nge njihem më kush jam, ngë njoh më horën dhe më duket sikur se ajo u bë një horë e huoj pë' mua.

Ishtë e vërtetë që sot si sot duhet të integrohemi, të bëhemi evropjanë me një kulturë më të zgjertë, po kjo ngë do të thot që të bjerrësh kulturë jote.

Dhe atëhera cila ish kultura jone, cilet ishën ato karakteristika që na jipjën gjithnjërisht ka ne të kishëm një identitet dhe që të dijëm kush ishëm?

Për së pari na e kishëm të qartë që, me gjithë historinë të përbashktë me italianët, na kishëm një histori tjetër e dijëm që origjina jone ish ka një dhe i huoj.

Për së dyti gjuha jone nëng ish lëtishti të horëvet përrëzë, po arbërishti i mësuor rreth vatrës së shtëpisë dhe ndë mes të rrugavet e horës.

Me të vërtetë këta gjëra i rruojtëm pë' më shumë se pesë qind vjet, po mund thomi që edhe sot ishtë këstu?

Kujtohem, dhe më vjen keq pse ngë shkoven shumë vjet, kur hora jone ishi ka të parët ka politika pë' shpirti i lirë të arbëreshëvet që ngë mbajën një mizë ka hunda, kur këngat arbëreshe mbushjën Portën dhe të gjithë ka hora kërkojën të shkruojën një këngë me gjuhën e tyre, kur hora ishi plot me murales që na mbajën ndër mend kaha vijëm dhe si u bëmë.

Gjthë këto gjëra u' ng' i shoh më. Njerëzit e horës jone ngë janë më ata që ishën njëherë. Një pjesë e vogël e vogël duket që ka pak interes pë' storjen dhe kulturën e vendit. Tjerit, dhe janë maxhoranxa, janë ata që ngë do të flasën më arbërishtin pse arbërishti ngë na duhet, janë ata që fshinjën muralset dhe që këndonjën këngat italjane dhe amerikane.

Ndë këtë kontekst me të vërtetë u' ngë njihem më dhe ngë di të përgjegjem pyetjes KUSH JAM?

Pa storje, pa gjuhën e saj, pa ide, kjo horë do shkurtohet fare dhe do të bëhet kalidhe pse ata veta që do kenë një identitet marrën dhe shkonjën gjatë saj pë' të krijuor një identitet tjetër.



*Luis de Rosa*

## Chi siamo oggi?

Non so voi, ma io ogni volta che torno al paese quando me ne assento, non riesco ad identificarmi, non riconosco più il paese e mi sembra come se fosse diventato straniero per me.

È pur vero che oggi come oggi bisogna integrarsi, diventare europei con una cultura più vasta, ma ciò non vuol dire perdere la propria cultura.

E allora qual'era la nostra cultura, quali erano quelle caratteristiche che davano ad ognuno di noi l'aver una identità e sapere chi eravamo?

In primo luogo avevamo ben presente che, sebbene con una storia comune con gli italiani, noi avevamo un'altra storia e che la nostra origine fosse straniera.

In secondo luogo la nostra lingua non era l'italiano dei paesi vicini, ma l'arbërisht imparato attorno al focolare e tra le strade del paese.

Invero queste cose le abbiamo conservate per oltre cinquecento anni, ma si può dire che oggi sia ancora così?

Mi ricordo, e me ne rammarico perché non è tanto tempo fa, quando il paese era tra i primi in politica per lo spirito libero degli arbersci che non sopportavano soprusi, quando le canzoni arberesce riempivano la Piazza e tutti in paese cercavano di scriverle nella loro lingua, quando il paese

era pieno di murales che ci ricordavano l'origine e l'attualità.

Queste cose non le percepisco più. Gli abitanti non sono più quelli di una volta. Una piccolissima parte sembra che abbia un po' di interesse per la storia e la cultura locale. Gli altri, e sono la maggioranza, sono quelli che non vogliono più parlare arbërisht perché esso non ci serve, sono quelli che cancellano i murales e cantano in italiano o americano.

In questo contesto invero io non mi riconosco più e non so più rispondere alla domanda CHI SONO?

Senza storia, senza la sua lingua, questo paese cadrà in rovina e diventerà un casolare perché quelli che vogliono una identità decidono di abbandonarlo per andare altrove a crearsi una nuova identità.

*Luis de Rosa*



## Ruri me historinë e tij zbret në Shqipëri Ururi e la sua storia sbarca sbarca in Albania

Durrës. Qytetarët e Durrësit kanë ndjekur me interes të madh ekspozitën e çelur ditët e fundit në galerinë “Nikolet Vasia” nga arbëreshi Luis De Rosa. Në ekspozitë përshkruhet në detaje fshati Ururi me titullin “Fshati im, një fshat arbëresh”, ku janë përmbledhur të gjitha historitë dhe figurat e një prej fshatrave pranë Molizes në Itali. Ky fshat siç e quan edhe vetë De Rosa “ka nxjerrë në shekuj figura të historisë italiane, madje edhe politikanë që kanë kontribuar në qeverisjen e Italisë në vite. Në 40 stendat e kësaj ekspozite piktori dhe studiuesi De Rosa 65-vjeçar, na jep në gjuhën shqipe, historinë e vendlindjes së tij. Ai jeton prej vitesh në Durrës dhe kjo ndoshta ka tërhequr interesimin e qytetarëve intelektualë e krijuesve durrsakë, ku nuk kanë munguar edhe artistë dhe njerëz të kulturës nga Tirana në ceremoninë e përurimit. Duke folur mbi ekspozitën De Rosa u shpreh se “Ururi, nuk është fshat si gjithë të tjerët, pasi burra të këtij fshati në vitet 1960-1970 kanë qenë politikanë të njohur dhe deputetë në Parlamentin e Italisë, si Tomaso Palmioti 20 vjet kryetar i bashkisë para se të bëhej deputet, apo Luigi Occhioneron dhe Mario Tanasi arbëreshë, që veç ministër në di-

sa qeveri, ishte edhe zv/kryeministër i Italisë”. Në ekspozitën e tij me ngjyra shihet Skënderbeu, figura më e nderuar jo vetëm e shqiptarëve, por edhe e fshatit arbëresh Ururi. Sipas historianëve, Ururi është themeluar në vitin 1465, tre vjet para vdekjes së Skënderbeut. De Rosa tha se “paraardhësit tanë erdhën në Itali të dërguar nga Skënderbeu në ndihmë të Mbretit të Napolit gjatë revoltës së baronëve të Apuglias kjo pjesë e historisë është ndërtuar me dokumente historike, në gravurat dhe foto shihen fragmente të kishave të hershme, të fisnikëve dhe brigantëve, që shpesh herë sulmonin duke arritur ta djegin atë”. Ururi dhe arbëreshët e kanë ruajtur gjuhën, traditat dhe zakonet. Qysh në vitin 1968 në fshatin Ururi u krijua Komiteti për Mbrojtjen e Gjuhës Arbëreshe, ku nuk mungonin edhe homazhet pranë monumentit të Skënderbeut në Romë. Ekspozita e Luis De Rosa ka foto bardhë e zi të 45 viteve. Ai ka botuar studime historike si “Mjeshtri dhe burri i dheut” apo “Unë jam arbëresh”, ndërsa drejton prej disa vitesh botimin e revistës së përmuajshme “Kumbora” të fshatit Ururi.

*Artur Ajazi*



## Gjergj Pelini, abat i Rotecit, diplomat i Skënderbeut

Dihet se shteti i Skënderbeut në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare aktivitetet më të gjera i zhvilloi në radhë të parë me Republikën e Venedikut, më pastaj me Rashën, Republikën e Raguzës, mbretërinë aragoneze dhe me papatin

Padyshim se njëri nga vargu i diplomatëve më të shquar të heroit tonë kombëtar për çështjen e Republikës së Venedikut qe abati i Rotecit Gjergj Pelini, për të cilin nga një burim që mban datën 30 mars 1441, informohemi se kishte origjinë kosovare. Qyteti i lindjes së tij ishte Novobërda. Nga viti 1438 deri në vitin 1463 e ndeshim për drejtues të kuvendit të Shën Mërisë në Rotec (Ratac – në gjuhën malazeze, gjendet në breg të Detit Adriatik, në perëndim të Tivarit, afër Sutomores). Abacia e Rotecit, gjatë kohës kur udhëhiqte abati Gjergj Pelini, qe nën jurisdikcionin e arqipeshkëvit të Tivarit, përkatësisht ishte dioçezë e saj. Mirëpo, duhet thënë se marrëdhëniet midis abatit të Rotecit dhe të argjipeshkëvit të Tivarit nuk ishin gjithëherë të mira. Mosmarrëveshjet mes vete erdhën në shprehje veçmas në kohën kur abacina e Rotecit e udhëhiqte abati Gjergj Pelini, i cili me të drejtë aspironte të emërohet për argjipeshkv të Tivarit.

Sipas të dhënave që kemi, aktivitetin diplomatik abati Gjergj Pelini e filloi në vitin 1438. Zotërojmë me njoftime se Pelini që në vitin 1441, në një mision diplomatik në Itali e shoqëroi Gjin Gazullin, i cili tashmë kishte bërë emër humanisti dhe diplomati të nivelit evropian.

Në shërbim të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut e ndeshim duke filluar nga viti 1448 dhe deri në fund të jetës së tij, deri në vitin 1463. Gjatë këtyre viteve, derisa Pelini i udhëhiqte misionet diplomatike të fatosit tonë në Republikën e Venedikut, çdo herë bëri përpjekje të jashtëzakonshme më qëllim që t'i ndihmojë Skënderbeut duke përfituar nga Republika e Venediku, atëbotë një ndër fuqitë më të mëdha të Evropës. Në këtë frymë e zhvilloi tërë aktivitetin e tij diplomatik, i cili zgjati afër 25 vjet. Mirëpo, ishte bukur vështirë t'i dalë në skaj realizimit të këtij misioni paqësor, meqë, qeveria venedikase asnjëherë nuk qe e sinqertë që t'i zbatonte në jetë vendimet që dilnin nga traktatet paqësore me Skënderbeun. Por dhe marrëdhëniet me shtetin arbëror Venediku i zhvillonte që të shfrytëzohej njëkohësisht qëndresa

heroike e popullit shqiptar kundër osmanëve, me pretekst të ruajtjes së qyteteve të njohura të bregdetit shqiptarë të rrezikuara nga osmanët, të cilat gjatë kësaj kohe qenë nën sundimin e Republikës. Që në vitin 1448 (4 tetor) Gjergj Pelini mori pjesë bashkë me zotin Andreun, ipeshkvin e Arbërisë për negociator i Skënderbeut dhe i Nikollë Dukagjinit në traktatin e paqes, që u lidhë midis Skënderbeut dhe Venedikut. Në këtë marrëveshje paqësore Republikën e përfaqësonin dy burra me plotë autoritet. Është fjala për kontin e Shkodrës Paolo Loredanon dhe proveditorin e Arbërisë venedikase Andrea Venerierin. Traktati i paqes, që u nënshkrua në kampin e Skënderbeut, caktonte që Danja t'i mbetej Venedikut, por me pretekst që edhe Skënderbeu të shpërblehet, si, p.sh. me një pension të përvitshëm prej 1400 dukatesh; me një hua prej 1500 dukatesh; me qëllim që të bashkohej me Janosh Huniadin kundër osmanëve; me një përjashtim takse të përvitshme për 200 kuaj të ngarkuar me kripë nga Durrësi; me strehim në tokën venedikase në rast se Skënderbeu dhe abatë e tij do të dëboheshin nga Shqipëria prej osmanëve, dhe me dy palë petka skarlate çdo vit në shkëmbim të dy langojve dhe dy skifterëve qe Skënderbeu do t'ia jepte Venedikut. Disa vendime që dalin nga traktati në fjalë i referohen edhe Nikollë Dukagjinit. Edhe pas kësaj marrëveshjeje, prapëseprapë Venediku nuk hoqi dorë nga synimet e mëparshme ndaj shtetit të Skënderbeut, gjë që mund të pasqyrohet më së miri me rastin e rrethimit të parë të Krujës, kur Republika e furnizonte me ushqim ushtrinë osmane, duke e vështirësuar më tepër mbrojtjen e qytetit. Edhe në vitet e mëvonshme Venediku i vazhdoi provokacionet e tij kundër pushtetit të fatosit tonë. Këto provokacione morën përpjestime të mëdha sidomos pas forcimit të miqësisë shqiptaro – aragoneze. Gjatë rrethimit të parë të Krujës ishte në rrezik se mos po shpërthente përsëri lufta me Venedikun. Por venedikasit u tërhoqën duke i dhënë urdhër kontit të Durrësit që t'u ndihmonte arbërve. Në fillim të muajit tetor të vitit 1450 Skënderbeu për qëllime t'i frenonte aspiratat

venedikase në Arbëri, nëpërmjet Pelinit ia ofrojë Republikës Krujën. Por, sipas një vendimi të Senatit venedikas që mban datën 23 nëntor 1450 oferta u refuzua, meqë Venediku nuk kishte forca që ta mbronte qytetin në fjalë. Misionet e abatit Pelin prej vitit 1448, në emër të Skënderbeut, radhiteshin një pas një. Atë e ndeshim edhe në vitin e ardhshëm, përkatësisht më 6 shtator 1451, kur bëri negociatë lidhur me çështjen arbërore me disa ambasadorë venedikas nga Pirani i Istrisë. Edhe pse venedikasit nuk u angazhuan sa duhet për ruajtjen e paqes me arbërit, dhe nuk i respektuan vendimet e saj, këtë injorancë të Republikës u mundua ta kompensoi Pelini me aktivitetin e tij të njohur diplomatik. Në këtë ndërmarrje ai nuk i kursej as mjetet e veta materiale. Me ndërmjetësimin e tij në vitin 1456 u arrit marrëveshja e sërishme midis Republikës dhe Skënderbeut. Po në këtë vit Pelini u emërua protonotier apostolik. Tashti, duke e pasur këtë cilësi ai përpilonte karta për Skënderbeun. Edhe pse me ndërmjetësimin e Pelinit në vitin 1456 u arrit marrëveshja, në emër të heroit tonë kombëtar, abati ynë shkoi për Venedik, me qëllim që ta sjellë ankesën për mospagesë e provizionit, si dhe për mosrespektimin e privilegjeve të parapaguara sipas marrëveshjes së tyre. Sipas burimit të njëjtë informohemi se, në mënyrë që t'i paguhej provizioni Skënderbeut, proveditori venedikas Francesco Venier mori në korrik të vitit të njëjtë 1200 dukate nga mjetet e Pelinit, i cili gjerë me atë vit kishte huazuar nga arka e Venedikut më tepër se 11.000 dukate. Kjo shumë dëshmon qartazi për mundësitë e mëdha financiare të Pelinit, i cili ofronte edhe më tej borxhe në të holla. Kështu, nga mjetet e tija gjatë vitit 1462, morën hua dy herë nga 600 dukate. Në vitin 1457, me qëllim të zgjatjes së ndihmës në të holla, kushtuar luftës heroike të popullit arbëror në krye me Skënderbeun, abati ynë u angazhua në një mision që shkoi të papa Kaliksti III. Po në këtë vit Pelinin e ndeshim sërish në Romë në cilësi të diplomatit të Republikës. Abati energjik i Shën Mërisë së Rotecit e dha kontributin e vetë edhe rreth marrëveshjes së heroit tonë kombëtar me funksionarët venedikas në Shqipëri, të cilët bashkë me Skënderbeun në vitin 1458 u ngritën kundër Lekë Dukagjinit, meqë ky mbante lidhje me osmanët. Këtë marrëveshje e solli Pelini në Venedik në mua-


jin gusht. Venedikasit qenë të kënaqur, meqë kjo i kishte dhënë fund luftës së pashpallur dhjetëvjeçare dhe, më 1458 filluan marrëveshjet paqësore me Skënderbeun. Pajtimi ishte aq i përzemërt, sa që Skënderbeu ua ktheu prapë venedikasve kështjellën e Shasit në vitin 1459. Venedikasit, madje, e shpërblyen edhe Pelinin për ndërmjetësimin e tij të mbarë. Pas pajtimit në vitin 1458 midis Venedikut dhe Skënderbeut, Republika arriti që përsëri të fitonte lirinë e kalimit nëpër viset e Durrësi dhe të Lezhës. Për këtë arsye si shpërblim për këtë fitore diplomatike Senati venedikas, jo vetëm që aprovoi dhënien e provizionit për vëllezërit e Gjergj Pelinit, Nikollës dhe Palit, të parit 10 ndërsa të dytit 6 perperë në muaj, por premtoi se edhe pas vdekjes së Gjergjit do t'ua jepte atyre provizionin e tyre. Heroi ynë kombëtar pati nevojë që edhe në vitin 1460 Pelinin ta dërgonte në një mision diplomatik në Venedik. Po në këtë vit Skënderbeu abatin tonë e emëroi për prokurator të vetin. Sipas një letre nga viti 1462, ka të ngjarë që të jetë shkruar nga papa Pio II, të botuar në veprën e vetë monumentale që mbanë titullin *Comentarii*, Skënderbeu pati sërish telashe me Venedikun. Që këtej, më 6 prill të këtij viti Senati venedikas i shkroi princit të Shkrodrës që të ftohet Pelini, i cili sikur gjithëherë deri më tani, do të gjejë mundësi për pajtimin e sërishëm të tyre. Lidhur me çështjen e krijuar janë ruajtur 3 dokumente të buriimit venedikas, që mbajnë datën e 27 gushtit, 10 shtatorit, dhe 20 shtatorit. Sipas tyre informohemi se Pelini arriti ta bindë Senatin venedikas, jo vetëm t'ia vazhdojë pagesën e provizionit vjetor në lartësi 600 dukate, por edhe t'i kompensohet Gjergj Kastriotit e tërë ajo shumë e papaguar gjer në atë kohë.

Në kushte të krijuara pas paqes së Shkupit, venedikasit dëshironin që ta afronin sa më tepër Skënderbeun, i cili ishte i gatshëm për të hyrë në negociatë. Atëbotë, përkatësisht në muajin gusht 1463, abati i Rotecit Gjergj Pelini për herë të fundit shihet në Venedik duke kryer një mision diplomatik në emër të fatosit tonë. Pas vdekjes së Gjergj Pelinit në fund të vitit 1463, një kohë të shkurtër si diplomat i Skënderbeut në Venedik e ndeshim Pal Gazullin. Më vonë, ndërkaq, këtë funksion diplomatik e kryente argjipeshkvi i Durrësit Pal Engjëlli. Në këtë mision Pelinin e shoqëroi Ndre Snatiku, të cilin e ndeshim

për herë të parë sipas dokumentacionit që e zotërojmë, në kryerjen e një misioni kaq të rëndësishëm diplomatik. Përmes tyre, më 20 gusht të vitit në fjalë u lidh një aleancë shqiptaro-venedikase kundë osmanëve. Klauzolat e kësaj aleance ishin këto: së pari Skënderbeu kishte për të rifilluar luftën kundër osmanëve me kusht që të merrte ndihmat e nevojshme dhe përforcime me kontingjente venedikase; së dyti, shumta e ndihmave do të caktohet drejtë për së drejti prej Këshillit të Madh të Republikës së Venedikut dhe Gjergj Pelinit, ose prej pasardhësit e tij, dhe jo prej proveditorëve venedikas në Shqipëri; së treti, një numër luftanijesh dhe anijesh ndihmëse venedikase do të dërgoheshin në ujërat shqiptare për të mbrojtur vendin dhe popullatën; së katërti, në rast se e diku do të përfundonte ndonjë paqe me osmanët, Shqipëria do të përfshihej në kushtet e traktatit; së pesti i biri Skënderbeut do të pranohet në listën e bujarëve venedikas; së gjashti, në rast se do të dëbohej nga Shqipëria, Skënderbeut do t'i bëhej strehimi dhe përkrahja në tokën e venedikasve, të cilët do ta ndihmonin që të rifitonte shtetin e tij; dhe së shtati, pensioni i papaguar i tij duhet të paguhej në Venedik dhe jo prej proveditorëve venedikas në Shqipëri. Burimet e shumta që u përmendën më sipër dhe të tjerat që do të marrin në shqyrtim në ndonjë artikull tjetër, shpiejnë që patjetër të përkujtohet edhe në këtë rast se, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, si dhe pararendësit e tij më parë, që nga fillimet e veta ishin ngushtësisht të lidhur me burra të shquar kosovarë të kohës së tyre, si dhe me ngjarjet që kishin përfshirë këtë pjesë të Arbërisë, prej nga ndërlidhet origjinën e tyre, çështje për çka kemi bërë fjalë më se njëherë.

**\*Prof. Dr Jahja Drançolli**

drejtor i Institutit Arkeologjik të Kosovës dhe shef i Katedrës së Historisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës.



## Mbinjeri 2030

Kam përherë te sytë shëmbëlltyrën e bariut plak me të bardhën mjekër e lënë dhe kësulën leshi përherë vënë mbi krye. Të sprasmen herë ç'e pash, ish me delet dhe mbahej shtuara me dy shkleke, dy furka nën sjetullat. I shtrëngojë me të dyja duart dhe lëvizet tue përparuar kembë e furkë bashkë. Shpejt, si marionetë.

Ëh! Njeriu ka përherë përdorur proteza, për të rritur forcën e veprimit prodhues të të vetmevet duar: shkop, mburu, drapër, shat, dyqirjan, etj. Tjera proteza kanë fuqizuar forcën luftarake: në vete mjeti vjen më para se qëllimi i përdorimit. Nga leva ngjera te rrota, nga motorët ngjera te makinat llogaritëse nga barnat galenike ngjera te bio-mjekësitë, një stërmadhe masë gjërash të reja është (/u ka) derdhur te jeta e njeriut, tue i rritur atij njerëzimin. Megjithatë, nëse gjithë këta të përparuar ka klënë të vërtetë tek e shkuamja, nani jam i bindur se kjo ngë është e ndodhet më e se ngë do të ndodhet tek e ardhmja. Në të vërtetë, çë sot, në vërehet një të përgjithshme 'jermi plotmundësie' të perëndimit, edhe më shumë dëftohet si tendencë për vjetët e ardhshëm.

Raporti 'Global trend 2030', parashtruar presidentit Obama nga 'National intelligence council-i', çë bashkëradhit hulumtimet e 17 agjencive të SHBA për spiunazh e mbledhje informacionesh, parashikon marrëdhënie të reja me forcë ndër kombet dhe evolucione shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

Por rritja e aftësivët njerëzore ngë intereson po ushtarët. Kjo idé e 'mbinjierit' është e pranishme edhe te plani për 'teknologjitë konvergjente', dal nga 'National science foundation-i' i SHBA. Konvergjencia të tilla ndër lidhin Nanoteknologji, Bioteknikë, administrim të Informacionit dhe shkencë e njohjevet ('cognitive') (NBIC), për të manipuluar lëndët, modifikuar organizmat e gjallë, mbledhur më të madhin e informacionet, për të vepruar mbi e brënda mendjes së njeriut.

Çë sot kush merr 10 pilula ngaditë për të sjellë një jetë me një cik dinjitet, llojas: «Jam o ngë jam më u'? Jam natyror edhe?». Njeriu mënd të fuqizojë qosmet e kurmit dhe të mendjes por do të kërkojë të die nëse qëndron vete o nëse ndërton njëjtësi.

Çë njerëzim ë' një njerëzim i 'të dopuarshmit'? E nëse pra kjo sipër-pajisje është e rezervuar kujt ka më shumë parà, ngë rritet, ndoshta, çapëlimi, çarja shoqërore ndër pak përdorues të fuqizimit e shumica pa e fuqizuame?

Çë ndjenjë ka të dish të bësh, nëse ngë ndëlgon atë çë j'e bënë?

## Superuomo 2030

Ho negli occhi l'immagine del vecchio pastore con la sua barba bianca incolta e la calotta di lana sempre posta sul capo. L'ultima volta che lo vidi, era con le sue pecore e si sorreggeva con due lunghe forche sotto le ascelle. Le stringeva con le mani e si spostava avanzando gamba e stampella insieme. Velocemente, come marionetta.

Sì! L'uomo si è sempre servito di protesi, per aumentare l'efficacia della azione produttiva delle mani nude: bastone, manico, falce, marra, forcone, ecc. Altre protesi hanno potenziato la sua efficacia bellica: in sé il mezzo precede la destinazione d'uso.

Dalla leva alla ruota, dai motori agli elaboratori, dai preparati galenici alle bio-medicine alla microchirurgia, una enorme massa di cose nuove ha invaso la vita dell'uomo, aumentandone l'umanità. Tuttavia, se questo progredire è stato forse vero nel passato, ora francamente dubito molto che questo stia accadendo e lo sarà nel futuro. Infatti, se già oggi si osserva un generale 'delirio di onnipotenza' dell'occidente, ancor più si manifesta come tendenza per i prossimi anni.

Il rapporto 'Global trend 2030', presentato al presidente Obama dal 'National intelligence council', che coordina le analisi di 17 agenzie USA di spionaggio e raccolta informazioni, prevede nuovi rapporti di forza tra le nazioni ed evoluzioni sociali, economiche e culturali.

Ma l'aumento delle prestazioni umane non interessa solo ai militari. Questa idea del 'superuomo' è presente anche nel progetto sulle 'tecnologie convergenti', varato dal 'National science foundation' USA. Tali convergenze collegano Nanotecnologia, Biotecnica, gestione della Informazione e scienze Cognitive (NBIC), per manipolare la materia, modificare gli organismi viventi, raccogliere il massimo delle informazioni, operare sulla e nella mente dell'uomo.

Già oggi chi assume 10 pastiglie al giorno per poter condurre una vita appena dignitosa, pensa: «Sono o non sono più io? Sono ancora naturale?». L'uomo può potenziare le risorse del suo corpo e la sua mente ma si chiederà se rimane se stesso o se cambia identità.

Che umanità è una umanità di 'dopati'? E se poi questa super-dotazione è riservata a chi ha più soldi, non cresce, forse, la divaricazione sociale tra i pochi fruitori del potenziamento ed i molti non potenziati? Che senso ha saper fare, se non si comprende quel che si fa?

E pra. Sa qëndron të individit? Njëjtësia ë' ndoshta po biologjike formë o ë' jatër-gjë? Sot te bota e punës veprimet të individit, të llogaritura, paracaktuara majdhena (/madje) porositura nga aparati teknik ç'i përket, ngë shprehin njëjtësinë e tij por të vetmin funksionalitet të tij; liria e tij, katandisur në rol. Më lik!

Brezat e reja, lënë jashtë nga jeta e tyre vetjake, çëkur e kanë ndier këtë 'të ngrysur të së ardhmes'. Për të parën herë te historia, njerëzimi rron si brënda njëi 'shpirtëror mot të keq' të përhershëm, vetëm, pa ngushëllimin vërtetimesh besimtare o politike. Për këtë arsye venë tue shpërthyer te bota kryengritje çë ngë janë shprehje ëndërrash o utopish ideologjike por fryt të njëi vetëdijeje të brëndshme çë riletet. Kur hjidhe ndaj së ardhmes, kjo të siell të rizbullosh të lashtit por nëse këta dy qëronje janë të ndarë, çonjë te balsamimi i traditës dhe te shuarja e modernitetit. Bashkë, për kundër, gjallërojnë e japin rëndësi dhe forcë njeriut. Breza, sot të përjashtuara nga e nanishmja, e kërkjnë te 'realiteti i vërtetë'. Pa lënë (/begënisur) e shkuamen dhe të ardhmen, sepse nanishmja ë' 'vendi i përpjekjes së tre qëronjevet', ku lidhen 'veprimi e soditja'. Na duhet një filozofi të nanishmes, e së cilës një nga të mundshmit themele të jetë përvoja: burim njerëzimi (khs. Octavio Paz, Fjalim për çmimin Nobel e Letërsisë, 1990).

Abstrakte ndëlgesa eprore të programuara nkutunuku (/ngutthi) janë e kundërta e farës njerëzore, çë u formua dal'e dalë në sajë të njëi evolucioni natyror për t'u përshtatur të gjithave situatat dhe ambientet.

Ëh! Të rritet mirëklënia fizike dhe ekonomike ë' imperativ mjet emancipimi por kurrë sa të duhurit njerëzimi, mirësie dhe njëi cike mirësjellje.

*Pal Borxha*

*Paolo Borgia*

## Kuzhina : Receta

### Tullumba

Për 25 copë duhen:

Për brumin:

Miell 1 gotë, vaj ose gjalpë 2-3 lugë gjelle, vezë 3-4 kokrra, pak kripë e sheqer, ujë trecerek gotë.

Për shurupin:

Sheqer 2 gota, ujë 2 gota, vaj për skuqje.

Brumi për tullumba përgatitet duke zier në uje miell së bashku me gjalpë ose yndyrë tjetër dhe pas zierjes ky brumë përzihet me sasi të madhe vezësh, Për ti dhënë formën tullumbave përdoret një vegël e dhëmbëzuar. Forma mbushet me brumë dhe vihen të piqen nga të dyja anët në zjarr të nxehtë. Pas skuqjes hiqen nga zjarri dhe hidhen në shërbet të ftohtë ku mbahen 1-2 minuta. Pastaj hiqen dhe rreshtohen në pjatë.



## Miqesia

Dikur ishin 2 shok që duheshin aq shume saqë mund te sakrifikonin gjithçka per njeri tjetrin. Ishin njohur gjatë studimeve e kishin qëndruar në te njëjtën shtëpi. Njeri prej tyre dukej si më kurnac, kurse tjetri shume bujar.

Vjen nje ditë që shokut kurnac i ishin prishur punët e biznesit. Asnje përpjekje nuk ndikonte ne përmirësimin e punës . Shkon tek shoku i tij bujar e i kërkon që ta ndihmojë me nje shumë të caktuar të hollash. Miku i tij nxorri ç’kishte e ia dhuroi me shume dëshirë. “Urdhëro vëlla, gjithçka kam le te jete e jotja”, i tha dhe ashtu u ndanë.

Shoku që nuk kursehej per asgjë, tashmë ishte fejuar e priste që së shpejti te martohet. Miku i tij kurnac, vjen ,e fton per kafe. “Dua të te them diçka shume të rëndësishme, por s’di se si”, i tha ai. Te ketë vallë gjë më te rëndësishme se miqësia jonë? – Ju kthye miku bujar.

Dëgjo vëlla, mua me pëlqen shume e fejuara jote, prandaj dua te martohem me të, tha ai duke ulur kokën përdhe. Pas nje qetësia të dyfishtë, miku bujar u mendua gjatë e nga dashuria që kishte per shokun e tij s’ia refuzoi atë. “Le te bëhet ajo që thua ti”, - i tha e kështu u nda nga e fejuara per te bërë te lumtur mikun e tij.

Kalojnë vite dhe punët e mikut te mirë po i shkonin keq e më keq. “Të shkoj te kërkoj pune tek miku im”, tha ai me vete. “Ai duhet te më ndihmojë patjetër.”, vazhdoi ai. Kur trokiti ne portën e mikut të tij dhe i kërkoj punë, ç’të shikonte e ç’të dëgjonte. “Nuk kam si të te ndihmojë”, i tha ai e ashtu e përcolli. I miri, i mërziur per atë që kishte ndodhur nisi te mendonte sërish pozitivisht. “S’ka gjë, s’dihet si kanë ardhur punët, prandaj s më ndihmoi dot... Kaluan dite djali bujar takon n’rrugë 1 burrë te vjetër e te sëmurë, që po i afronte vdekja. E merr, e çon ne shtëpinë e tij , e ndihmon dhe e përcjell deri diku ku mund te gjente shtëpinë e tij. Pas disa ditësh ai tashmë kishte vdekur. 1 avokat troket ne derën e shtëpisë së djalit bujar e i thotë që plaku te cilin kishte ndihmuar kishte qenë shume i pasur dhe i kishte lënë atij te gjithë pasurinë që kishte. Kalojnë ditë e javë dhe djali, tashmë i pasur, merr 1 shtëpi pranë asaj te mikut të tij. 1 ditë, teksa po kthehej në shtëpi, pranë portës takon 1 grua të lodhur e te sëmurë që i kërkon diçka per të ngrënë pasi ishte shume e uritur. Djali, e merr ne shtëpi, e ushqen dhe duke qenë se jetonte vetem i kërkon asaj që te qëndrojë me të. “Ti merru me punët e shtëpisë dhe me gatimin, un shkoj ne punë e vij. Kështu as ti s’mbe-

## L’amicizia

Una volta c’erano 2 amici che si volevano tanto bene da sacrificarsi l’uno per l’altro. Si erano conosciuti durante gli studi ed avevano condiviso la stessa abitazione. Uno dei due si mostrava avaro, mente l’altro molto generoso.

Arriva un giorno che all’amico avaro andarono male gli affari dell’impresa. Nessun tentativo riuscì a risolvere gli affari. Allora si rivolge all’amico generoso e gli chiede di essere aiutato con un prestito.

Il suo amico gli diede quello che aveva e glielo concesse volentieri. “Vedi, fratello, tutto ciò che ho è a tua disposizione” gli disse e si accomiatarono.

L’amico che non si risparmiava nulla, si era fidanzato ed aspettava di sposarsi al più presto. Il suo amico avaro, arriva e lo invita per un caffè. “Vorrei dirti una cosa delicatissima, ma non so come dirtela” gli disse. “Ma va là, cosa c’è di tanto delicato più importante della nostra amicizia!” ribatté il generoso.

“Senti, fratello, a me piace molto la tua fidanzata perciò vorrei sposarmi con lei” - gli disse chinando la testa verso terra. Dopo un silenzio di entrambi, l’amico generoso, pensandoci a lungo, per l’amore che nutriva per l’amico, non rifiutò. “E va bene, come vuoi tu”- gli disse e lasciò la fidanzata per rendere felice il suo amico.

Passarono anni e gli affari dell’amico buono andavano di male in peggio. “Adesso passo a cercare lavoro dal mio amico” - si disse fra se. “egli mi aiuterà senz’altro” pensò. Quando bussò alla porta dell’amico a cercare lavoro, cosa vide e cosa sentì. “Non ho come aiutarti”- gli disse e lo scacciò di casa. Il buono, addolorato per quello che era successo incominciò di nuovo a pensare positivamente. “Non fa niente, non si sa come sta con gli affari, perciò non mi ha potuto aiutare ...”. Passarono giorni ed il generoso incontra per strada un uomo vecchio e malato, moribondo. Lo prende, lo aiuta e lo accompagna sino dove poter trovare la sua dimora. Dopo alcuni giorni quegli era morto. Un avvocato bussa alla porta del generoso il quale gli comunica che il vecchio che aveva aiutato era una persona molto ricca e che gli aveva lasciato tutta il suo patrimonio. Passarono giorni e il generoso, ormai ricco, compra una casa vicina a quella dell’amico. Un giorno, mentre tornava a casa, davanti la porta incontra una donna stanca e malata che gli chiedeva qualcosa da mangiare che era molto affamata. Questi la prese in casa, la nutre e visto che era solo le chiese di restare con lui. “Tu fai i lavori di casa e di cucina, mentre io vado e torno al lavoro. Così ne tu starai in strada,

tesh rrugëve, as unë s'vuaj nga këto gjëra", tha ai. E moshuara pranoi me kënaqësi. Pas disa kohësh, gruaja, e kthyer në një nënë për djalin që e kishte ndihmuar aq shume, i kërkoi atij që të gjej 1 vajzë e të martohet. "Ne fakt, dhe unë kam menduar, por deri tani smë ka dalë ndonje njeri i përshtatshëm përballë", thotë djali. Gruaja i propozoi të martohej me një vajzë që e njihje nga afër. 2 të rinjtë njihen dhe më në fund vendosin të martohen. Erdhi koha për dasmën dhe të riut bujar i duhej të mendonte për të ftuarit. Sido që punët kishin ardhur, atij i duhej të ftonte dhe mikun e tij të vjetër. "Miqësia jonë duhet të jetë me e fortë se keqardhjet. Prandaj do ta ftoj dhe atë në këtë ditë të lumtur timen.", mendoi dhe i dërgoi ftesën. Në ditën e dasmës, dhëndri e nusja dukej se ishin më të bukur se gjithkush tjetër. Nisi muzika e të gjithë po argëtoheshin më së miri. Dhëndri, merr mikrofonin dhe nisi të shpjegojë historinë e jetës së tij. Një herë e një kohe, kam pasur 1 mik për kokë. E doja shume e jepja kokën për të. Një ditë, kur punët po i shkonin keq, më kërkoi para e i dhashë gjithçka. Një ditë tjetër, më kërkoi të fejuarën që e doja shumë. I mërztur, i dhashë dhe atë, se në ishim miq, e donim njeri-tjetrin. Pas disa kohësh, kur unë isha në gjendje të keqe ekonomike, ju drejtova atij e i kërkova punë. Smë dha, madje me një zë të vrazhdë gati sa smë përzuri. U mërztua, por përsëri s'mund të mendoja keq për të. Ishte miku im i shtrenjtë. Pas këtyre fjalëve, miku kurnac, më sytë e përlotur merr mikrofonin dhe nis të tregojë: Një herë e një kohë dhe unë kisha një mik për kokë. Kur punët po më ecnin siç duhet, i kërkova ndihmë e më dha gjithçka që kishte. I kërkova dhe të fejuarën edhe atë ma dha. Arsyeja pse i kërkova të fejuarën, ishte se ajo vajzë s'ishte e duhura për të, ishte 1 grua e pamoralshme. Në këtë mënyrë, shpëtova mikun tim të shtrenjtë nga ajo grua jo e denjë për të. Një ditë, kur punët po i shkonin mirë miku erdhi e kërkoi punë nga unë. Une si dhashë diçka të tillë, pasi smund të urdhëroja atë që të bënte diçka në atë ambient. Ndërsa, burri i moshuar që miku im takoi në rrugë, ishte babai im. Im atë ishte në prag të vdekjes e unë e dërgova pranë mikut tim. I kërkova babait që të gjithë pasurinë që kishte t'ia linte atij. Kurse, gruaja lypsare që i erdhi në shtëpi, është nëna ime. E dërgova atë që të kujdesej për mikun tim e ta ndihmonte që të kalonte 1 jetë sa më të qetë. Ndërsa vajza me të cilën miku im po martohet, është motra ime. Unë e binda atë që të martohej me te,,,,

*Nga interneti*

ne io soffrirò di queste cose", le disse.

La vecchia accettò volentieri. Dopo un po' di tempo, tramutatasi in una mamma per il ragazzo che l'aveva tanto aiutata, gli chiese di trovarsi una ragazza da sposare. "Infatti, anch'io l'ho pensato, ma finora non ho ancora trovato nessuno che fosse adatta per me." le rispose il giovanotto. La donna gli propose di sposarsi con una ragazza che conosceva bene. I due si conobbero ed infine decisero di sposarsi. Giunse il tempo del matrimonio ed il giovane generoso pensava per gli inviti. Comunque fossero andate le cose, doveva invitare anche il suo vecchio amico. "La nostra amicizia dev'essere più forte dei rancori. Perciò lo inviterò in questo mio giorno felice", pensò e gli mandò l'invito. Nel giorno del matrimonio, lo sposo e la sposa apparivano i più belli. Iniziò la musica e tutti si divertivano soddisfatti. Lo sposo, prende il microfono ed incominciò a spigare la storia della sua vita. Una volta, un tempo ho avuto un amico inseparabile. Gli volevo bene e data la testa per lui. Un giorno, gli andarono male gli affari, mi chiese dei soldi e gli dato tutto. Un altro giorno, mi chiese la fidanzata che tanto amavo. A malincuore, glielo data, perché eravamo amici e ci volevamo bene. Dopo un po' quando io ero in situazione economica avversa gli ho cercato lavoro e non me l'ha dato, anzi mi ha sgridato e quasi offeso. Mi rincerebbe, ma di nuovo non potevo pensar male di lui. Era il mio amico più caro. Dopo queste parole, l'amico avaro, con gli occhi in lacrime, prese il microfono ed incominciò a raccontare. Una volta, un tempo, anch'io avevo un amico inseparabile. Quando gli affari mi andarono male gli chiesi aiuto e mi diede tutto quello che aveva, gli chiesi la fidanzata e me la diede. Il motivo per cui gli ho chiesto la fidanzata era perché non andava bene per lui, era una donna immorale. In questo modo ho salvato il mio amico da quella donna non degna per lui. Un giorno, quando gli affari gli andarono male l'amico mi cercò lavoro. Io non gli diedi nulla di ciò, perché non potevo imporgli di umiliarsi in quell'ambiente. Mentre il vecchietto che l'amico trovò per strada era mio padre, mio padre era moribondo e lo mandai dal mio amico. Chiesi a mio padre di lasciare tutto il suo patrimonio a lui. Mentre la mendicante che ritirò in casa era mia madre. La mandai perché si prendesse cura del mio amico e di aiutarlo a condurre una vita quanto più serena. Mentre la ragazza con la quale il mio amico si sta sposando è mia sorella. Io l'ho convinta a sposarsi con lui...

*Da internet*

*Nëse pyet për mua*

Nëse pyet për mua  
 i thoni se ka vdekur  
 Nëse kërkon varrin  
 i thoni s' gjindet  
 në fund të detit  
 Nëse kërkon trupin  
 I thoni se është mykur  
 Nëse kërkon Shpirtin  
 i thoni se pushon diku  
 Ne thellsi te tokes  
 nese kerkon Syt emi  
 i thoni se nga lotet  
 U verbuan

*Se chiede di me*

Se chiede di me  
 ditele che è morto.  
 Se cerca la tomba  
 ditele che non si trova  
 in fondo al mare.  
 Se cerca il corpo  
 ditele che s'è ammuffito  
 Se cerca l'anima  
 ditele che riposa  
 nelle viscere della terra.  
 Se cerca i miei occhi  
 Ditele che per le lacrme  
 Si sono accecati



*Një poezi të pakryer*

Të guxosh  
 do të thotë ta bësh dikë të lumtur  
 të rrokullisesh  
 si i marrë nëpër dëborë  
 ta përqëndrosh  
 një burrë të shpërqëndruar  
 t'i bëhesh shtëpi  
 një të pastrehu që dridhet  
 t'i bëhesh prehër  
 një burri - fëmijë të dashuruar  
 të hysh mes krahëve  
 dhe t'i derdhesh trugut të burrit  
 Të guxosh  
 do të thotë ta gjuash  
 diellin a hënë me gurë  
 t'i thërrasës shiut të ngrire,  
 bjer i tëri, aq më bën për ty  
 të mbetesh pa frymë  
 kur s'e mendon kur kalon ajo  
 të shtangesh, të bëhesh budalla,  
 të të mekët zëri para saj  
 të harrosh se ku je  
 të harrosh se ke peshë,  
 madhësi a përmasë  
 Të guxosh  
 do të thotë të digjesh  
 të jetosh në flakë...

*Una poesia incompleta*

Osare  
 vuol dire rendere qualcuno felice,  
 rotolarsi  
 come pazzo nella neve,  
 stabilizzare  
 un uomo ramingo,  
 costruire una casa  
 ad un senzatetto infreddolito,  
 fare un giaciglio  
 ad un giovanotto innamorato  
 entrare tra le braccia  
 e tuffarsi nel corpo dell'uomo .  
 Osare  
 vuol dire cacciare  
 il sole o la luna con i sassi,  
 chiamare la pioggia gelata  
 di cadere tutta, tanto che mi faccia per te,  
 di rimanere senza fiato  
 quando non la pensi quando essa passa  
 sbalordirsi, diventare scemo,  
 che ti si paralizzi la voce davanti a lei,  
 dimenticarsi dove sei,  
 dimenticare che hai un peso,  
 una grandezza una dimensione.  
 Osare  
 vuol dire bruciarsi,  
 vivere nella fiamma...

*Rexhep Shahu*

*Rexhep Shahu*

## I pronomi interrogativi

Il pronome relativo (**cili, cila**) viene utilizzato anche come pronome interrogativo ed in questo caso non utilizza le particelle prepositive.

### *Maschile*

Cili ?  
( quale? )

		Singolare			Plurale
N.		<b>cili</b>			<b>cilët</b>
G.	(të)	<b>cilit</b>	(të)		<b>cilëvet</b>
D.	(të)	<b>cilit</b>	(të)		<b>cilëvet</b>
Acc.		<b>cilin</b>			<b>cilët</b>
Abl.		-			-

### *femminile*

cila ?  
( quale ? )

		Singolare			Plurale
N.		<b>cila</b>			<b>cilat</b>
G.	(së)	<b>cilës</b>	(të)		<b>cilavet</b>
D.	(së)	<b>cilës</b>	(të)		<b>cilavet</b>
Acc.		<b>cilën</b>			<b>cilat</b>
Abl.		-			-

(continua)

### Alfabeti Arbëresh

I njëjti me atë shqip sipas Kongresit të Monastirit (1908) dhe Kongresit i drejtshkrimit të Tiranës (1972).

Uguale a quello Albanese secondo il Congresso di Monastir del 1908 ed il Congresso dell'ortografia di Tirana del 1972.

A	come in Italiano	N	come in Italiano
B	come in Italiano	NJ	come la "GN" di <u>gn</u> omo
C	come la "Z" di <u>p</u> azzo	O	come in Italiano
Ç	come la "C" di <u>c</u> ielo	P	come in Italiano
D	come in Italiano	Q	come la "CH" di <u>ch</u> ostro
DH	come la "TH" inglese " <u>th</u> e"	R	come in Italiano
E	come in Italiano	RR	come la "RR" di <u>carro</u>
Ë	suono semimuto	S	come la "S" di <u>s</u> anto
F	come in Italiano	SH	come la "SC" di <u>sc</u> immia
G	come la "G" di <u>g</u> allo	T	come in Italiano
GJ	come la "GH" di <u>gh</u> ianda	TH	come la "TH" inglese di <u>th</u> ink
H	suono sempre aspirato	U	come in Italiano
I	come in Italiano	V	come in Italiano
J	come la "I" di <u>i</u> eri	X	come la "Z" di <u>z</u> anzara
K	come la "C" di <u>c</u> ane	XH	come la "G" di <u>g</u> iacca
L	come in Italiano	Y	in Arbërisht a volte "I" a volte "U"
LL	suono velato gutturale	Z	come la "S" di <u>s</u> osa
M	come in Italiano	ZH	come la "J" francese di <u>j</u> our